

TAKIMI XII I PËRBASHKËT I KP-E DHE KP-KRF Konsolidimi i pasqyrave financiare të sektorit publik: përfshirja e njësive të qeverisjes vendore dhe NSH-ve

11-13 nëntor 2025



CFRR >>>

Centre for Financial and
Sustainability Reporting Reform



PULSAR 

Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR is an initiative of:



PULSAR is co-funded by:

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance





**Seanca 1 KP-E: Përfshirja e temave të
agregimit dhe konsolidimit në programet
mësimore universitare dhe në programet e
formimit profesional**



*Giovanna Dabbicco, PhD, studiuese e lartë
ISTAT, Drejtoria e Llogarive Kombëtare, Romë -
Itali*



Aktualiteti dhe dobia e raportimit financiar të konsoliduar (RFK) për qëllime të përgjithshme

Programi:

- Hyrje dhe çështja kryesore
- Sfidat dhe faktorët e suksesit për hartimin e pasqyrave të konsoliduara •

Objektivat normativë për mësimin

- Objektivat e propozuara për mësimin
- Mendime në përfundim

Aktualiteti dhe dobia e raportimit financiar të konsoliduar (RFK) për qëllime të përgjithshme

5

- Konsensusi në literaturën akademike lidhur me rolin, rëndësinë, përdorimin dhe përdoruesit e RFK-së (Chow et al., 2015), por në nivelin e qeverisjes vendore ka dëshmi kontradiktore nga literatura dhe praktika
- Njësitë e kontrolluara (NSH) nuk përfshihen gjithmonë në RFK.
- Disa çështje për t'u mbajtur parasysh nga perspektiva teorike por edhe nga ajo teknike
- RFK shkon përtej një procesi të thjeshtë përputhshmërie, për të promovuar qeverisjen e mirë, transparencën dhe vendimmarrjen e informuar
- A është RFK i rëndësishëm si RFQP apo si RFQV?

Sfidat dhe faktorët e suksesit për hartimin e pasqyrave të konsoliduara

6

- Procesi i eksternalizimit të shërbimeve publike jo të përfshira plotësisht në pasqyrat financiare individuale ngre pyetje lidhur me transparencën dhe llogaridhënien
- RFK jep një zgjidhje konceptuale për këtë mungesë informacioni
- Dobia e kornizës së llogaridhënies dhe vendimmarrjes
- Faktorë të rëndësishëm shtytës, të identifikuar në përvoja:
 - Sqarimi i kontrollit në të gjitha nivelet e qeverisjes (QQ – AV)
 - Përfshirja e parlamentit në proces e lidhur me dëshirën për transparencë dhe llogaridhënie më të madhe në realizimin e shërbimeve publike, duke theksuar rëndësinë që ka ekzekutivi dhe parlamenti për llogaridhënien ndaj qytetarëve
 - Kontabiliteti (dhe planifikimi buxhetor) me të drejta dhe detyrime të konstatuara kanë hapur rrugën për publikimin e llogarive për të gjithë qeverisjen
 - Mbështetje kyçe e njësive ekonomike **me formim** (edhe në nivel universitar), mbështetje teknike & publikim të materialeve udhëzuese

Objektivat mësimorë nga diapozitivat e kursit të formimit të BSNKSP-së

7

- SNKSP 34, Pasqyrat financiare të veçanta
- SNKSP 35, Pasqyrat financiare të konsoliduara
- SNKSP 36, Investimet në pjesëmarrje dhe në sipërmarrje të përbashkëta
- SNKSP 37, Rregullimet e përbashkëta
- SNKSP 38, Raportimi i interesave në njësitë e tjera
- SNKSP 40, Bashkimet në sektorin publik
 - Duhet të jeni në gjendje:
 - ❖ Të zbatoni kërkesat për hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara
 - ❖ Të kuptoni përkufizimin e “kontrollit”
 - ❖ Të kryeni procedurat e konsolidimit

Programi ideal i formimit: objektivat e propozuar mësimorë

8

- Përdorimet dhe përfitimet RFK-së
- Objekti i konsolidimit – probleme kryesore
- Probleme të veçanta për qeverisjen vendore (QV) si njësi raportuese
- Çështje komplekse për RFK-në
- Lidhja me raportimin statistikor
- Përdorimi i materialeve mësimore përkatëse, për shembull i standardeve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare
- Përfshirja e shembujve të shumtë praktikë

Përdorimet dhe përfitimet RFK-së

9

- Rrit e transparencën dhe fuqizon llogaridhënien
- Mundëson vlerësimet e performancës së qeverisë në administrimin e burimeve
- Mbështet reformat e financave buxhetore, planifikimin afatgjatë dhe bashkërendimin (p.sh., Estonia, Australia, Britania e Madhe, Suedia)
- Ndhmon vendimmarrjen e brendshme (e drejtuesve) dhe të jashtme (e politikanëve)
- Krijon një burim unik referimi ku shpjegohen burimet dhe detyrimet totale të shtetit, çka i jep mundësi qeverisë (dhe të tjerëve) të vlerësojnë më mirë pozicionin financiar, duke mundësuar krahasime afatmesme dhe afatgjata të agregateve kryesore të kontabilitetit

Objekti i konsolidimit – probleme kryesore

10

- Objekti i konsolidimit shpesh zhvillohet nga përvoja praktike
- Njësitë e kontrolluara (publike ose private) nuk përfshihen gjithmonë në RFK
- Qeveria qendrore nuk ushtron “kontroll” mbi disa njësi në nivel vendor ...?
- Materialiteti dhe krahasueshmëria ndryshojnë për shkak të strukturave të ndryshme të NSH-ve
- Kufijtë e konsolidimit ndryshojnë: perspektivat juridike, organizative, buxhetore dhe të kontrollit
- Krahasueshmëria globale nuk është qëllimi kryesor i RFK-së

Probleme të veçanta për qeverisjen vendore (QV) si njësi raportuese

11

Raportimi i QV-së është kompleks për shkak të decentralizimit, agjencizimit dhe korporatizimit.

- Debat: A duhen përdorur përkufizime më të gjera të kontrollit (p.sh., varësia financiare)?
- Mund të nevojitet raportim diferencial për njësi më të vogla ose më pak komplekse
- Duhet marrë në konsideratë shkallë të ndryshme të varësisë financiare nga qeverisja qendrore
- RFK duhet të jetë i orientuar nga qëllimi: përse dhe për kë është përgatitur raporti?
- Duhet siguruar përputhshmëri në praktikat kontabël në të gjitha njësitë ekonomike.

Çështje komplekse për RFK-në

12

- Portofol kompleks i “një” organi (të qeverisjes vendore)
 - Aksionar në një sërë shoqëri të cilat mund të kenë:
 - Forma të ndryshme juridike (publike ose private)
 - Struktura të ndryshme pronësie (plotësisht publike ose të përziera publike-private) dhe
 - Përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të ndryshme publike, siç janë farmacitë, shkollat dhe çerdhet, ujësjellësi, gazi, largimi i mbetjeve dhe strehimi.
 - Marrëdhëniet kontraktore me disa njësi që u është ngarkuar kryesisht detyra e ofrimit të shërbimeve sociale

Çështje komplekse për RFK-në

13

Universitetet

- Nuk konsolidohen në pasqyrat financiare shtetërore kur nuk është e qartë se cila njësi qeverisjeje “kontrollon” universitetet ose, përndryshe, nëse universitetet janë të pavarura
- Pikëpamje alternative: është mirë që universitetet të konsolidohen me shtetin për qëllime raportimi financiar për arsye llogaridhënieje, pasi marrin shuma të konsiderueshme fondesh publike
- Përdorimi i kriterit kontabël. Për shembull, fuqia për të komanduar politikat e përditshme të shfrytëzimit të universiteteve (edhe pse universitetet duhet të kenë plan strategjik sipas objektivave të politikave arsimore shtetërore).

Dallimet mes SNKSP-ve dhe Puna e ESA/GFS nga aspekti i kufirit të raportimit

14

- Qasja e BSNKSP-së: Pasqyrat dhe raportet financiare, ose të detyrueshme ose vullnetare, në krahasim me ESA/GFS në Evropë për klasifikimin e secilës njësi institucionale qeveritare (rezidente) në SQP për qëllime statistikore
- Qeverisja qendrore është një njësi unike sipas ESA/GFS, por mund të mos jenë njësi raportuese më vete sipas SNKSP-ve.
- NSH-të e përjashtuara sipas SNKSP-ve nga objekti i raportimit, por të konsoliduara kur “kontrollohen”
- Qasja e rezidencës në ESA/GFS;
- GFS: SQP dhe sektori publik
- Një njësi institucionale e kontrolluar nga qeveria (një prodhues publik) është njësi institucionale rezidente që kontrollohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga njësitë rezidente të qeverisjes së përgjithshme ose prodhues të tjerë publikë.
- Sektori publik përbëhet nga qeverisja e përgjithshme dhe shoqëritë publike të tregut

Çështja e harmonizimit me raportimin statistikor

15

Përvojat:

- Këshilli Australian i Standardeve të Kontabilitetit 1049 Raportimi financiar i sektorit të qeverisjes si e tërë dhe i sektorit të qeverisjes së përgjithshme (AASB 1049)
 - Australia harton prej vitit 2000 një buxhet për sektorin (statistikor) të qeverisjes së përgjithshme, i paraqitur sipas bazës me të drejta dhe detyrime të konstatuara të GFS-së, siç është përgatitur nga zyra statistikore australiane. Pas kalimit në standardin AASB 1049 për qeverisjen si e tërë dhe GGS në vitin 2009 (AASB, 2007), përdoret një kornizë e harmonizuar e GFS dhe PPPK. Megjithatë, meqenëse nuk ka harmonizim mes GFS-së dhe standardeve të raportimit financiar, disa konsiderojnë se ofrojnë qasje alternative (pra nuk janë plotësuese).
- Llogaritë e qeverisjes si e tërë e Britanisë së Madhe (LLQT)
 - Në Britaninë e Madhe, me futjen në zbatim të SNRF-ve, është mundësuar harmonizimi i praktikave kontabël në mbarë qeverisjen, për të siguruar një pasqyrë financiare të konsoliduar për qeverisjen si e tërë të Britanisë së Madhe. Sektori publik i Britanisë së Madhe i ofron parlamentit dhe palëve të tjera kryesore të interesit rakordime të ndryshme, çka reflekton një theks më të madh në parimin e llogaridhënies dhe transparencës buxhetore (Dabbicco & Mattei, 2021).

Çështja e harmonizimit me raportimin statistikor

16

Pika për të mësuar në formim

- Çështja e harmonizimit me raportimin statistikor mund të ndikojë në zhvillimin e llogarive të qeverisjes si e tërë
 - ESA/GFS në krahasim me konceptin e kontrollit të SNKSP-ve: Qasja e sektorit institucional e ESA-së dhe marrëdhënia e kontrollit/funksioneve në krahasim me qasjen e kontrollit (fuqia/përfitimi) të SNKSP-ve
 - Njësia raportuese duhet të përcaktojë një qëllim për konsolidim dhe të konsolidojë në përputhje me rrethanat. Varet nga përdorimet dhe përdoruesit, por rakordimi nga hartuesit e dy sistemeve të raportimit është i nevojshëm në mënyrë që të mos ngatërrohen përdoruesit

Arsimi universitar dhe formimi profesional

17

Ndoshta nevoja të ndryshme të arsimit universitar dhe formimit profesional?

Fokusi i arsimit universitar:

- Njohuri dhe koncepte teorike (elementare dhe të avancuara):
- Njohuri për standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit
- Dije për kornizat siç zbatohen për konsolidimin
- Zhvillim i aftësive kritike dhe aftësisë për të analizuar tema të avancuara

Fokusi i formimi profesional:

- Ushtrime të tjera praktike të avancuara me raste studimore dhe skenarë
- Përdorim softueri dhe automatizim
- Drejtimi i brendshëm dhe administrimi i të dhënave (pra kapja e të dhënave, mbajtja e tyre, sintetizimi, përdorimi, analiza, publikimi, arkivimi i të dhënave)

Reflektime në mbyllje

18

- RFK mund të shërbejë për qëllime specifike - jo të lidhura me gjithçka - rëndësi ka të kuptohen përdorimet dhe përfitimet e tij
- Aspektet teorike të formimit duhet të marrin në konsideratë edhe:
 - Modelet e kontrollit dhe konsolidimit në nivel vendor
 - Kriteria të ndryshme konsolidimi (p.sh., kontrolli buxhetor).
 - Lidhjet me raportimin statistikor
- Referenca me standardet përkatëse dhe rastet studimore praktike (numerike) të dobishme për të rritur njohuritë